



SHQIP

69

*Përshendetje
pjesëmarrësve*

73

Hyrje

79

Programi





SHQIP

**“LE TI JAPIM DORËN NJËRI
TJETRIT DHE TË ECIM SË
BASHKU DREJT ATDHEUT
QIELLOR”**

*Përhëndetja drejtuar pjesëmarrësve të
TVË meeting*

Romë (Itali), 30 Korrik 2019

**LE TI JAPIM DORËN NJËRI TJETRIT DHE TË ECIM SË BASHKU
DREJT ATDHEUT QIELLOR ¹**

Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullar 119

Të dashur pjesëtarë të Urdhërit të Tretë dhe miq:

Mirëseerdhet të gjithë!

Qoftë bekuar Zoti që na lejon këtë takim të gëzueshëm me ju, laikë dhe miq të Institutit të Fjalës së Mishëruar, të ardhur nga 58 vende të ndryshme të botës! Është një gëzim i madh që kam mundësinë tu mikpres dhe tu shpreh personalisht mirënjohjen për kontributin tuaj madhështor kundrejt kauzës së Krishtit.

Ajo ç'ka e bën më domethënës takimin tonë është fakti që jemi këtu në Romë, seli e Vikarit të Krishtit mbi tokë, "si një familje e vetme, të bashkuar nga e njëjta fe, nga i njëjti qëllim, nga i njëjti mision, nga e njëjta karizëm, nga e njëjta natyrë dhe nga i njëjti shpirt"². Kjo gjë paraqet një rast unik për të dëshmuar së bashku bashkimin perfekt me Kishën dhe për të rrëfyer që motoja jonë është "së bashku me Pjetrin dhe poshtë udhëheqjes së Pjetrit"³ dhe që nuk kemi aspiratë më të madhe se sa ajo që të jemi të dobishëm për Mbretërinë e Krishtit ⁴.

Ju, që keni zgjedhur që të jeni tharmi (soda e bukës) që rinovon shoqërinë nga brenda, duke qënë gjithmonë afër njerëzve, jeni përgjigjja e Zotit për nevojat e pafundme për ungjillizimin e kësaj bote dhe një mbështetje e pazëvendësueshme për misionin e Institutin tonë.

Ajo ç'ka na karakterizon është sjellja e Fjalës së Mishëruar tek të gjithë njerëzit, është ngjizja e vlerave të shoqërisë me aromën e Krishtit, duke transformuar të prezencën e Tij të adhurueshme zemrat e njerëzve,

duke ndërmarrë vepra epike për kauzën e Tij, është lejimi i dashurisë së Krishtit që të mbretërojë në familjet, është ndezja e llampës përvëluese e së vërtetës së Fjalës së Mishëruar në katër anët e kësaj bote, edhe në situatat më të vështira dhe në realitetet me kundërshtuese. Jeni Ju, dëshmitarët kurajoz dhe koherent të detyrës dhe të misionit për ungjillizimin e kulturës, që na ndihmoni të sjellim Krishtin në vendet më të largëta, për të mposhtur realitetin për Zotin, duke mbjellur Ungjillin në vendet më të frekuentuara të jetës njerëzore.

Bashkëpunimi me ju të gjithë, pjesëtarët e urdhërit të Tretë dhe miq, në të gjitha misionet tona, është një ndihmë madhështore dhe efikase, në mënyrë që misioni që na ka qënë besuar brenda kishës të përhapet dhe të mbërrijë në ato vende dhe ambjente që janë më të frekuentuara nga shoqëria, dhe që do të ishte shumë e vështirë për ti arritur në një tjetër mënyrë. Ju siguroj që ndihma juaj në misionet tona është e pazëvendësueshme dhe jetësore.

Pa dyshim që këto janë ditë me hire speciale për të gjithë. Është dëshira ime e përzemërt për çdo njërin nga pjesëmarrësit që ky takim i parë ndërkombëtarë i pjesëtarëve të Urdhërit të Tretë Shekullor dhe e miqëve të IVE të rrisë shpirtin e familjes në ne dhe që të shërbejë si shtysë dhe kur të ktheheni në vendet tuaja të punoni me impenjim të madh për “të rregulluar punët e përkohëshme sipas vullnetit të Zotit⁵», duke ditur që nuk jeni vetëm në misione, por që keni me vete të gjithë Familjen Rregulltare që ju mbështet dhe që shpreson gjëra të mëdha nga ju. Më besoni që nga laikë të vendosur si ju «varet një pjesë e madhe e përhapjes së Mbretërisë së Zotit dhe e Familjes Rregulltare në botë»⁷, nga momenti që bashkimi i forcave është i vetmja gjë që shërben

për të arritur plotësinë e të gjitha qëllimeve të apostullatit të Institutit tonë dhe për të mbrojtur në mënyrë efikase të mirat e saj ⁸. Siç u thoshte Don Orione bijve të tij shpirtëror: «Le ti japim dorën njëri tjetrit dhe të ecim së bashku drejt atdheut qiellor. Le ta ndërtojmë njëri tjetrin me shembullin e mirë⁹». Ju inkurajoj me gjithë zemër që të vazhdoni duke dëshmuar Krishtin, Fjalën e Mishëruar, gjithmonë dhe në çdo vend.

Nuk mund të përfundoja pa shprehur se pari falenderimin e përzemërt për të gjithë ata që organizojnë këtë event: meshtarët, rregulltarët, motrat Shërbëtore të Zotit dhe të Virgjërës Matarà, bamirësat dhe natyrisht edhe një herë tjetër laikët tanë të dashur dhe miqt.

Falenderoj të gjithë ju për sforcimin që keni bërë për të ardhur. Ju lutem që kur të ktheheni në shtëpitë tuaja të sillni fjalët e mia inkurajuese dhe vlerësim të madh të gjithë pjesëtarëve të Urdhërit të Tretë që nuk kanë patur mundësi që të vijnë dhe falenderimin tim të singertë për mbështetjen që i japin misionëve tona.

Duke lutur ndërmjetësin e Zojës Mari, mbretëreshës së Apostujve dhe Yllit të ungjillizimit të ri, ju uroj çdo të mirë në kohë dhe për në përjetësi.

Në Krishtin, Fjalën e Mishëruar.



At Gustavo Nieto, IVE



SHQIP

HYRJE

Shpirti i këtij takimi

*Nuk na intereson të arrijmë në shume vende
ose te kemi shumë anëtarë,
nëse në këmbim të kësaj
humbasim shpirtin.*

*Nuk do e humbasim shpirtin
nëse do i rrimë besnik Kishës, në vetë personin e Pietrit...
duke ruajtur të plotë atë
që përfaqëson trashëgimia e Istitutit*

Cfr. Kushtetuta nr. 3

Të dashur pjesëmarrës të takimit IVE meeting: «Mirë se erdhet të gjithë!» Me këtë prezantim duam të përshkruajmë qëllimet e këtij takimi të parë ndërkombëtar të Familjes Rregulltare të Fjalës së Mishëruar dhe aktivitetet me të cilat do mundohemi ti arrijmë këto qëllime në këto ditë.

1- Shpallje publike besnikërie kundrejt Zotit tonë Jezu Krisht.

Qëllimi kryesor është të shpallim, në mënyrë publike, vullnetin tonë dhe dëshirën që Jezu Krishti të jetë i pranishëm në çdo ambjent të realitetit njerzor, si i vetmi shpëtimtar i saj, sepse *nuk ka tjetër Emër me të cilin mund të shpëtojmë*¹⁰. Në vitin 1925 Papa Piu i XI ka thënë që “shumë të këqija gjenden në botë sepse pjesa me e madhe e njerëzve kanë larguar Jezu Krishtin dhe ligjet e tij të shenjtë nga praktika nga jeta e tyre, nga familja e nga shoqëria”¹¹ e deklaroi fuqishëm që «nuk do mund të kishte kurrë shpresë e paqe të përhershme mes popullit përderisa individët dhe shtetet do i binin mohit Mbretërisë së Krishtit Shpëtimtar¹²». Jezu Krishti do të mbretërojë sepse për këtë qëllim ka ardhur në botë¹³. Kështu do i lutemi në këto ditë: «Mbretëro o Zot, mbi të gjithë njerëzit e mbi të gjithë realitetin njerëzor!». Me këtë dëshirë duam që në këtë takim «të ofrojmë njerëzit tanë në punë ... dhe të vihemi në shërbimin e tij¹⁴» deri kur Ai të Mbretërojë¹⁵. E bëjmë këtë me besim të plotë dhe me inkurajimin që na mëson se është Ai që na thërret të gjithëve¹⁶ që «tani ta ndjekim në dhimbje në mënyrë që më pas të gëzohemi me të në fitoren e Tij¹⁷». Me një zë të vetëm, si një familje unike, si laikë dhe si të kushtuar, «le të vendosim të gjitha forcat tona për të shpallur Ungjillin, ose më mirë për të sjellë Mishërimin në të gjithë njerëzit, në të gjithë njeriun dhe në të gjitha shfaqjet e njeriut»¹⁸.

Këto ditë duhet të jenë një dëshmi publike që vetëm duke konstatuar nevojën urgjente të Mbreterisë së Krishtit në botën e sotme, njeriu do jetë në gjendje të gjejë rrugën e tij drejt një shprese që nuk do e zhgënjeje më¹⁹ e do të mbushë boshllëkun e ankthit që ka në shpirtin e tij nga Ateismi dramatik i kohës sonë. Në një botë të shurdhët ndaj zërit të Krishtit, duam që shpallja jonë të tingëllojë në të gjithë tokën dhe për këtë duhet ta realizojmë të bashkuar në të njëjtin qëllim që është Krishti, në bashkim me Të, ashtu me të kushtuarit, me shokët dhe laiket e Familjes sonë Rregulltare.

2 -Të rinovojmë impulsin e apostullatit të laikëve.

Si Kongregatë Rregulltare jemi plotësisht «të bindur nga vlera e madhe që ka për jetën e Kishës shenjtërimi i laikëve»²⁰. Nga kjo bindje vjen natyrshëm që Instituti ti «dedikohet në mënyrë parësore formimit të laikëve»²¹, «në mënyrë që këta ti trajtojnë gjërat e përkohshme e ti rregullojnë sipas Zotit»²². Nuk mund të ecet në ungjillizimin e kulturës duke lënë pas dore tema që i përkasin asaj. Besnikëria këkron që të punojmë të bashkuar në përgjithësi për të gjithë miqtë që janë të bindur për detyrën urgjente të ungjillizimit të kulturës. Ky aspekt i përgjithshëm nuk duhet të jetë për ne fakoltativ por është «pjesë themelore dhe formuese e Institutit, ... nga e cila nuk mund të shmangesh, përderisa është vazhdim i aktiviteteve të Institutit në ambjentin e jetës laike»²³.

Nga ana tjetër, laikët nuk duhet të harrojnë thirrjen e ungjillizimit. Atyre u dedikohet Kushtetuta dogmatike Lumen Gentium në një tekst të një forcetë konsiderueshme: «Për thirrjen e tyre është e përshtatshme që laikët të kërkojnë mbretërinë e Zotit duke përdorur gjëart e zakonshme dhe të sotshme sipas vullnetit të Zotit. Jetojnë në botë, të dhënë pas punëve të ndryshme të botës dhe në kushtet e jetës së përditshme të familjes dhe shoqërisë. Disa janë të thirrur nga Zoti të kontribuojnë në shenjtërimin e botës duke u ushtruar nën udhëheqjen e shpirtit ungjilltar, dhe në këtë mënyrë shpallin Krishtin të tjerëve me anë të dëshmisë të vetë jetës së tyre dhe me besimin e tyre, me shpresën e mirësisë së tyre. *Atyre pra ju takon që të ndriçojnë dhe rregullojnë të gjitha gjerat e përkohshme, me të cilat janë të lidhur ngushtë, në mënyrë të atillë që të jenë vazhdimisht sipas Krishtit dhe ti japin lavdi Krijuesit dhe Shëlbuesit* ²⁴.

Don Orione thoshte që «sot, kush nuk është apostull i Jezu Krishtit dhe i Kishës, është një fe mohues» ²⁵.

Për këtë, duam që këto ditë të jenë lutje e thellë dhe reflektim mbi detyrën apostolike, duke patur parasysh që tani më shumë se kurrë «laikët duhet të marrin përsipër detyrën e rinovimit të rregullit të përditshëm dhe të udhëhequr nga drita e ungjillit dhe nga mendimi i Kishës dhe të udhëhequr nga mirësia e krishterë, të veprojnë në mënyrë direkte dhe në mënyrë konkrete brenda këtij rregulli» ²⁶.

Reflektimi ynë dhe prova jonë nuk reduktohen në ungjillizim vetëm si një detyrë, por si një «*stil ose mënyrë e vecantë* i apostullatit tonë»²⁷. Duhet të pyesim veten çfarë pret nga ne Krishti dhe Kisha për të qënë besnik ndaj asaj për të cilën jemi thirrur si anëtar të kësaj Familje Rregulltare. Nëse është e vërtetë që «në ungjillizimin tonë nuk ka asgjë që është rreptësisht e re»²⁸, por «është e jona sepse vjen nga vepra që rrjedhin nga kongregata të tjera, si psh Ushtrimet Shpirtërore, oratorët, misionet popullore etj»²⁹, në çdo rast nuk duhet të harrojmë «të përqëndrohemi në misterin e Mishërimit»³⁰. Këtë veçori duam ta përvetësojmë nëpërmjet konferencave plenare.

A photograph of St. Peter's Basilica in Rome, Italy, taken at sunset. The large dome and the facade are illuminated by the warm, golden light of the setting sun. The sky is a pale yellow. In the foreground, there are stylized, wavy bands of yellow and red, which serve as a background for the title and subtitle.

SHQIP

PROGRAMI I TAKIMIT

Përshkrim i aktiviteteve



**FAMILJA RREGULLTARE
E FJALËS SË MISHËRUAR**
ROMË 2019

30
KORRIK

SHQIP

15:00

Mbërritja - Regjistrimi

Kur të mbërrini tek Fraterna Domus, një rregulltarë do të konfirmojë regjistrimin, për të vijuar më pas me një të ri të grupit **Voces Verbi** i cili do tu shoqërojë në dhomat tuaja duke u dorëzuar çelësat, së bashku me ëantën me të gjitha materialet e nevojshme për takimin.

Vendi i
konferencës

Recepsioni

17:45

Rruzarja e Shenjtë me qirinj

Ndërkohë që presim aktin e fillimit të takimit, mund të vizitohet ekspozita, të pini një kafe ose të vizitoni Fraterna Domus.

Ju kujtojmë që kush dëshiron mund të shkojë kishë për lutjen e rruzares.

SHQIP

18:30

Akti i Fillimit

Vendi: Salloni Don Françesku.

Akti i fillimi të IVE Meeting do të fillojë me lutjen e Shpirit Shenjt e kënduar nga kori "Totus Tuus". Më pas do të shikojmë një video-përhëndetje të pjesëtarëve të jetës kontemplative (manastiret) të Familjes sonë Rregulltare, më pas do të jetë momenti i prezantimeve të pjesëmarrësve të shteteve të ndryshme dhe një përfaqësues nga çdo grup shkon me flamurin e vendit të vet duke vënë në dukje karakterin ndërkombëtarë të këtij takimi. Më pas kori do të këndojë himnin e këtij takimi të quajtur "Omnia in Christo Instauranda" për të filluar më pas me disa prezantime të tjerë nga disa shtete. Pastaj do të projektohet një video që shpjegon takimin. Në fund i këndojmë Zojës në gjuhë të ndryshme.



Salloni Don Francesco

19:30

*Mesha e Shenjtë***Udhëheq celebrimin:** At Diego Pombo IVE**Gjuha:** Italisht*Pjesëmarrja në Meshë është kulmi dhe zemra e çdo takimi tonë.**i**Dorëzimi i mesharëve në gjuhë të ndryshme përpara kishës.*

SHQIP



21:00

Darka festive

i

Kush ka shqetësime nga disa ushqime (çeliakët, laktozët etj) do të jetë një tavolinë me ushqimin e përshtatshëm, çdonjëri merr vetë atë që dëshiron.

SHQIP

i

***Si të lidhem me rrjetin
Wifi të Fraterna Domus:***

- Ti kërkoni personalit të Fraterna Domus që ndodhet në reception skedën (që kushton 1 euro në ditë)
- Të lidheni me rrjetin: "Fraterna Domus"
- Hapni në browser adresen: www.libero.it
- Shkruani adresën dhe fjalëkalimin (që ndodhet në skedë)

Wi Fi



22:00

Spektakël

Është dëshira jonë që ky takim të zhvillohet në atmosferën më të madhe të gëzimit festiv, gëzim “i cili është sekreti madhështor i të krishterit, është shpirtëror dhe mbinatyror dhe lind nga konsiderata e misterit të Fjalës së Mishëruar”³¹. Për këtë arsye ne do të realizojmë shfaqjet tona tradicionale me numrat muzikor dhe numrat klasikë qesharak të grupit “Shën Filipo Neri”. E gjithë kjo ka për qëllim përforsimin në ne të shpirtit familjar që nuk mund të zhgënjehemi, sepse “me të drejtë është jeta vëllazërore nëpërmjet së cilës ne tregojmë veten të bashkuar në Krishtin ...si një familje e veçantë rregulltare”³².

Vendi: Salloni Don Françesku.

SHQIP



Kohë e lirë



31
KORRIK

SHQIP

08:00

Adhurim Eukaristik

(FAKULTATIV)

ADHURIM I PËRZGJATUR

Në kishën kryesore do të ketë adhurim eukaristik gjatë gjithë ditës, nga momenti që Eukaristia «duhet të jetë një nga dashuritë tona më të mëdha»³³. Dëshirojmë që të gjithë pjesëmarrësit të kenë mundësinë që të adhurojnë Jezusin në çdo moment, pasi, siç thoshte Shën Pjetër Gjuljano Eymard, të adhurosh të Shenjtërueshmin Sakrament është «akti më i lartësuar, nga momenti që bashkëndan jetën e Marisë këtu në tokë, kur e mbante në kraharorin e virgjër, në grazhd, në Kryq apo në të Shenjtërueshmin Sakrament».



Akti më i shenjtë, pasi ky është ushtrimi perfekt i të gjitha virtyteve: feja, e cila është perfekte kur adhuron Jezu Krishtin e fshehur, të mbuluar e të përulur në të Shenjtërueshmën Sakrament; shpresa, nga momenti që, të mund të shpresojmë me durim qiellin e lavdisë për të na dërguar tek ai, Jezu Krishti krijoi të mrekullueshmën qiellin eukaristik; bamirësia, sepse siç është dashuria është i gjithë ligji, kjo përmushet në adhurimin e Zotit tonë në të Shenjtërushmën Sakrament me gjithë mendje, me gjithë zemër, me shpirt e praktikohet edhe me të gjitha forcat dhe duke adhuruar mund të praktikohet edhe bamirësia perfekte kundrejt të afërmit, duke u lutur për të dhe duke kërkuar në favor të tij hire dhe mëshirë nga Shpëtimtari. Akti më i drejtë, pasi adhurojmë Jezu Krishtin për ata që nuk e adhurojnë, e braktisin, e harrojnë, e përçmojnë dhe e ofendojnë»³⁴.

08:40

Bekim Eukaristik



MESHTARË TË DISPONUESHËM PËR RRËFIME

Dëshirojmë që ata të cilët marrin pjesë në këtë takim të kenë mundësinë për të bërë një rrëfim të mirë, dhe duke përfutur nga fakti që ka edhe shumë meshtarë mund edhe që tu kërkojnë këshilla në mënyrë personale rreth jetës shpirtërore. Kushtetuta jonë na kujton që lartësimi i çdo realiteti njerëzor për Ungjillin realizohet duke «ndriçuar meshtarët si drejtues shpirtëror, duke u dhënë aftësinë e përkohëshme dhe duke formuar laikë në mënyrë që ata “të trajtojnë dhe rregullojnë gjërat e përkohëshme sipas Zotit”»³⁵ një gjë e tillë do të ishte e pamundur pa një dialog intim dhe familjarë të çdonjërit nga ne me Jezu Krishtin, gjë që bëhet falë drejtimit nga një meshtarë.



09:00

Mëngjesi

Vendi: Salla e ngrënies.

10:00

Aktivitete për fëmijë

Gjatë zhvillimit të IVE Meeting, një grup rregullarësh do të jetë përgjegjës për të organizuar aktivitete formuese, kreative dhe praktika mëshire për fëmijët sipas shpirtit të oratorit, duke realizuar edhe mandatin e Zotit tonë që tha: «lejoni që fëmijët të vijnë tek unë, sepse e tyre është mbretëria e qiellit»³⁶. Fëmijët do të bashkëndajnë aktivitetet e përbashkëta (dreka, darka, spektakoli, Mesha dhe rruzarja) së bashku me pjesën tjetër të grupit.

SHQIP



Vendi i lojtrave

10:30

Konferenca Plenare

SHQIP


**MISTERI I MISHËRIMIT DHE
RËNDËSIA QENDRORE E KRISHTI NË
PLANIN HYJINOR**
At Miguel A. Fuentes, IVE

Ndërkohë që në kohën e shkuar tentativat për të mohuar Mishërimin ishin të vërteta edhe pse shumë të izoluar³⁷, Shën Gjon Pali i II konsideron që koha jonë, në vetvete, është e shënuar nga i njëjti mohim³⁸. Bashkimi i ngushtë i njeriut me Hyjninë e realizuar në një person të vetëm Jezu Krishtin, sot është e mohuar në tentativa të vazhdueshme për të ndarë Zotin nga realiteti njerëzor, sikur të ishin të kundërta me njëra tjetrën. Në këtë mënyrë bota mbinatyrore, nga e cila realiteti njerëzor varet në mënyrë absolute, është «e lidhur në një të shkuar të largët apo në një qiell të largët»³⁹ dhe, për sa kohë disa bashkohor admirojnë Jezusin, «Ai është akoma larg»⁴⁰. Në të vërtetë nuk është i njohur, i dashur dhe i bindur, pohon Papa i madh.

Mohimi i bashkimit të Zotit me njeriun, i realizuar nga Mishërimi, ka sjellë «pasoja të mëdha», ose ndryshe thënë kulturën e vdekjes, për të cilën jemi dëshmitarë direkt, që aprovon fjalët profetike të Chesterton: «hiq të mbinatyrshmen dhe do ngelet vetëm ajo që nuk është natyrore»⁴¹.

Degradimi i familjes, i seksit, aborti, eutanazia janë rezultat i një mohimi të tillë. Kësaj i shtohet fakti që «kur Jezusi përjashtohet dhe mohohet, vizioni ynë i kuptimit të ekzistencës njerëzore është e reduktuar; sepse kur shpresojmë dhe aspirojmë për dicka inferiore, shpresa zëvendësohet nga dëshpërimi dhe gëzimi nga depresioni»⁴². Një rezultat i madh kur mohojmë Mishërimin është «të konsideruarit e lidhjes individuale me Zotin si një lidhje personale dhe private në mënyrë që të jetë e ndarë nga proceset nëpërmjet të cilave udhëheq aktiviteti social, politik dhe ekonomik»⁴³. Është e nevojshme të mos ambjentohe mi me kulturën e vdekjes, me shkatërrimin e familjes, me një shoqëri politike të ndryshme nga Ungjilli. Duhet të jemi të parët që ti mposhtim këto dhe për këtë është e nevojshme të lartësojmë flamujt e Mishërimit të Fjalës, sepse vetëm Krishti mund ta shpëtojë njeriun dhe të gjithë realitetin njerëzor nga mizerja që vjen nga mohimi i Krishtit Zot.



Gjuha: Spanisht

Të gjitha konferencat plenare do të zhvillohen në dy sallone kryesore: në Auditorium dhe Sallën Don Francesku.

- Hap këtë konferencë me një solo me kitarë Cristiano Paolini.



Për të shkuar nga Auditorium në sallën Don Françesku duhet zbritur nga këto shkallë.



11:30

Pushim-kafe

EKSPOZITË

Gjatë pushimeve ndërmjet konferencave plenare, mund të vizitohet Ekspozita që ndodhet në sallonin e madh para Sallonit Don Françesku. Ekspozita do të qëndrojë e hapur dhe në gadishmëri për vizita gjatë ditës!

Ekspozita e IVE meeting ka si qëllim tu bëjë që të njihni karizmën e familjes rregulltare të Fjalës së Mishëruar, duke prezantuar elementet e padiskutueshme dhe apostullatet e ndryshme në shumë misione nëpër botë.

Për këtë arsye çdo ditë do të ekspozohen gjëra të ndryshme të lidhura ngusht edhe me konferencat plenare dhe grupet e reflektimit;

i

Do të jetë një vend tjetër ku keni mundësi për të dëgjuar dhe blerë CD e regjistruar nga rregulltarët eskluzivisht për këtë takim, përfshin edhe disa këngë të regjistruara nga misionarët tanë.



12:15

Konferenca Plenare



**KARIZMA E INSTITUTIT TË FJALËS SË
MISHËRUAR**

At Gonzalo Ruiz, IVE

Rikonfirmimi i Fjalës së Mishëruar, është ajo që Zoti do të ngjallje në Familjen tonë të vogël Rregulltare të Fjalës së Mishëruar. Shpirti Shenjt na dhuron një karizëm, një hir të veçante të marrë nga themeluesi dhe e drejtuar në ndërtimin e gjithë Kishës, deri kur ata që e marrin të mund të dëshmojnë me jetën e tyre vetë virtytet e Krishtit në Mishërimin e Tij, duke jetuar virtytet e përlësisë dhe trashëndencës, duke qënë thelbësisht si Krishti në Mishërim. Në këtë mënyrë, duke qënë «kelkë të mbushur me Krishtin që derdhin mbi të tjerët bollëkun e tyre»⁴⁴, mund ti kushtojmë Atij të gjithë njerëzit dhe të gjithë realitetin njerëzor. Ndaj kësaj karizme, që realizohet në rradhë të parë në vetë personin që më pas tu ofrohet të tjerëve, janë të thirrur të gjithë rregulltarët dhe në një mënyrë të vecantë dhe sipas kushteve të tyre, edhe laikët e Urdhërit të Tretë dhe në përgjithësi çdokush që bashkëndan detyrën urgjente të ungjillizimit të kulturës.

SHQIP

i

Gjuha: Italisht.
Hap këtë konferencë me një solo
me violinë novici Jan Sedlicky



13:30

Dreka



Kohë e lënë

SHQIP


15:30

Grupe Reflektimi

**USHTRIMET SHPIRTËRORE TË SHËN INJACIT TË
LOJOLËS.
RËNDËSIA DHE PËRHAPJA**

“Në dimensionin e tij shpirtëror, Institutit do ti duhet të përballlet me ungjillizimin e kulturës nëpërmjet shenjtërimit të individëve. Kjo do të kryhet, mundësisht, me predikimin e Ushtrive Shpirtërore sipas metodës dhe shpirtit të Shën Injacit të Lojolës”⁴⁵.

Në historinë e Kishës, Ushtrimet Shpirtërore kanë një traditë të gjatë që dëshmon për efektivitetin e tyre të lartë si një mjet për shenjtërimin personal, në të cilin bazohet vendi preferencial që ata duhet të zënë në lidhje me metodat e tjera. Papët vetë e kanë theksuar rëndësinë e përhapjes së tyre: “nëse në të gjithë dhe në të gjitha klasat e shoqërisë së krishterë, ushtrimet shpirtërore do të përhapen dhe do të praktikohen me zell, do të vijë një rigjenerim shpirtëror; mëshira do të ushqehet, energjitë fetare do të forcohen, shërbimi i frytshëm apostolik do të zgjerohet dhe së fundi, paqja do të mbretërojë në individët dhe në shoqëri”⁴⁶. Ky konsiderim i rëndësishëm dhe i pasurisë së ushtrimeve Shpirtërore “duhet të na udhëheqë për të njohur të njëjtën gjë në thellësi, për t’u përgatitur për



t'i promovuar ato me entuziazëm duke i afruar shpirttrat këtij burimi të veçantë nga i cili rrjedh hiri i Zotit i cili është i përbërë nga Ushtrimet Shpirtërore³⁴⁷.

Ka shumë laikë të cilët janë të përkushtuar për t'i përhapur ato, duke organizuar aspektet praktike, duke ftuar pjesëmarrësit, duke kërkuar dhe madje duke ndërtuar një vend ku mund të realizohen.



SHQIP

Grupet e reflektimit në gjuhë të ndryshme drejtohen nga relatorët e mëposhtëm:

1. Italia, Shqipëria - **At Marcelo Lattanzio, IVE**
2. Spanja, Argjentina, Peru, Ekuador -
At Emilio Rossi, IVE
3. USA, Papua Guineja e Re- **At Mariano Vicchi, IVE**
4. Filipina - **At Bernardo Ibarra, IVE**
5. Brasili - **At Reinaldo Satiro, IVE**
6. Ukraina - **At Teodoro Matspaula, IVE**
7. Rusia, Tayikistan, Kazakistan -
At Ariel Alvarez, IVE
8. Hong Kong - **At Carlos Almonte, IVE**
9. Kina- **At Matias Fang, IVE**
10. Taiwan - **At Michael Zhang, IVE**
11. Gjermania - **At Tobias Eibl, IVE**
12. Lixenburg, Franca dhe Tunizia -
At Silvio Moreno, IVE
13. Lindja e Mesme, Egjipti, Jordania, Iraku, Tanzania
At Gabriel Romanelli, IVE



Kohë e lirë

17:15

Grupe reflektimi

1. TË RRITURIT

TAVOLINA E RRUMBULLAKËT: “BASHKËPUNIMI I LAIKËVE NË APOSTULLATET E IVE”.

Do të ketë prezantime të apostullateve të ndryshme konkrete që disa laikë, pjesëtarë të familjes sonë rregulare, aktualisht kryejnë. Në këtë mënyrë, ne mund të vëzhgojmë shembuj konkret të bashkëpunimit në detyrën e Ungjillizimit të kulturës, në kontekstin që i takon laikëve. Temat do të jenë si më poshtë:

- “Laikët dhe apostullati për thirrjet e shenjta”, drejtohet nga Sonia Ibarra nënë e 8 rregulltarëve në IVE.

- “Laikët dhe puna e tyre në apostullatin me të rinjt”, drejtohet nga Tomas Borrel, organizues i ditëve të formimit në Spanjë.

- “Bashkëpunimi i laikëve në shtëpitë e mëshirës të IVE”, drejtohet nga Myroslav Voznyak, pjesëtari i parë i Urdhërit të Tretë në Ukrainë dhe organizues i Marshimit për jetën.

- Laikët dhe apostullati me mjetet e komunikimit”, drejtohet nga At Agustin Ambrosini IVE.

*i***Gjuha:** Spanisht**Vendi:** Auditorium**Drejtues:** At Ernesto Caparros, IVE

2. TË RINJT

TË RINJT DHE UNGJILLIZIMI I KULTURËS

Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor thekson rëndësinë e përkushtimit ndaj formimit të të rinjve, për të ruajtur vitalitetin e karizmës “Shkronjat e këtij libri do të jenë të vdekura nëse nuk do të dini të formoni të rinjtë me një shpirt të madh që dinë të transmetojnë gjeneratave të reja karizmën e Familjes sonë Rregulltare”⁴⁸. Për këtë arsye, një refleksim mbi apostullatin e të rinjve që po zhvillohet në Familjen tonë Rregulltare vendoset në një mënyrë imperative, si për shembull Voces Verbi, CIDEPROF, “Kryqëtarët e Jezusit”, Oratorët etj. Në këtë mënyrë do të jetë e mundur të vlerësojmë si “të përshtatëshme veprat dhe aktivitetet me gjendjen e të rinjve dhe transformimet kulturore që trondisin botën e të rinjve”⁴⁹, në mënyrë që përpjekjet e apostullatëve tona të jenë sa më efektive, që të jetë e mundur në “njohjen e të rinjve personalisht, vlerësuar të mirat e tyre, për të edukuar ndërgjegjen e tyre dhe për t’i edukuar ata në mënyrë që të përdorin mirë lirinë e tyre, për t’i entuziazmuar me ideale të mëdha, t’u ofrojmë atyre kryqin për ta përqafuar atë dhe kështu të jetojnë kuptimin e vërtetë të fesë”⁵⁰. Në mënyrë konkrete, do të përpiqemi të reflektojmë se si i riu, duke marrë karizmën e duhur për Kongregatën tonë, mund të japë fryt duke marrë mbi vete virtytet e Mishërimit dhe të jetë në gjendje ta zhvillojë atë në apostullatet konkrete në favor të ungjillizimit të kulturës.

i

Gjuha: Italisht**Vendi:** Salla Don Françesku**Drejtues:** At Andres Bonello IVE,
dhe të rinjtë e Voces Verbi.

19:00

Mesha e Shenjtë

Udhëheq celebrimin: At Juan Emilio Rossi IVE
Gjuha: Portugalisht.

20:30

Darika

21:30

*Rruzarja e Shenjte,
me qirinj*

“Ne duhet të jemi apostujt e Marisë, duke iu kushtuar Asaj në skllavëri amnore të dashur dhe duke bërë gjithçka”
 “nëpërmjet Marisë, me Marinë, në Marinë dhe për Marinë”⁵¹.
 Kushtetuta jonë thotë se “çdo skllav i besueshëm i Jezusit në Marinë duhet ta lusë, ta përshëndesë, ta mendojë, të flasë për Të, ta nderojë, ta lavdërojë, të gëzohet dhe të vuajë me Të, të punojë, të lutet dhe të pushojë me Të dhe së fundi, të dëshirojmë të jetojmë gjithmonë përmes Jezusit dhe Marisë, me Jezusin dhe me Marinë, në Jezusin dhe në Marinë, për Jezusin dhe për Marinë». Dhe për këtë arsye, përveç ripërtëritjes së Kushtetutës sonë dhe ofrimit të rruzares së shenjtë të përditëshme, çdo ditë do ta nderojmë atë me një procesion në nderim të saj.



99

Programi

SHOP



22:15

Spektakël



Kohë e lirë



1
GUSHT

SHQIP

08:00

Adhurim Eukaristik

(FAKULTATIV)



08:40

Bekim Eukaristik

i

I Shenjtërueshmi Sakrament do të qëndrojë i ekspozuar gjatë gjithë ditës për adhurimin të përzgjat.

09:00

Mëngjesi

10:30

Konferenca Plenare



**FORMIMI I DREJTUESVE LAIKË PËR
MBRETËRINË SOCIALE TË KRISHTIT**

At Daniel Cima, TVE

Kjo karizëm ka nevojë në mënyrë direkte të ketë lidër laikë që sjellin në sferën e tyre të përkohëshme Mbretërinë sociale të Krishtit.

Për vetë natyrën që ka njeriu, kërkon të jetojë në shoqëri⁵². Është pikërisht «esenza e tij sociale që kërkon të shfaqë jashtë tij aktet e brendëshme të besimit, që të komunikojë me të tjerët mbi besimin, që të shpallë besimin e vet në mënyrë komunitare»⁵³. Besimi nuk mund të jetë një fakt privat, pa ndikuar në shoqëri⁵⁴, dhe Jezu Krishti nuk është Mbret vetëm i sferës personale, por i gjithë krijimit. Ja pse duhet të jenë laikë të vërtetë të krishterë që aplikojnë në mënyrë të denjë Ungjillin e Jezu Krishtit në realitetin shoqëror. Lidër të vërtetë që, në një botë gjithmonë e më armiqësore duhet të jenë plot me kurajo. Pikërisht atyre, i bindur nga vështirësitë që kanë, Gjon Pali i II u thotë: «Mos kini frikë! Hapni, ose më mirë shembni dyert që të hyjë Krishti! Hapuni fuqisë së tij shëlbimprurëse kufinj të shteteve, kufinj të sistemeve ekonomike e politike, kufinj të kampit të madh të kulturës, të civilizimit e të zhvillimit. Mos kini frikë!». Papa Leoni i XIII ka vënë re se problematika sociale është një «problematikë nga e cila nuk mund të gjejmë zgjidhje pa ju drejtuar besimit dhe Kishën»⁵⁵.

i

Gjuha: Italisht

Hap këtë konferencë kori "Totus Tuus".

11:30

Pushim-kafe

12:15

Konferenca Plenare

SHQIP



MISIONI I URDHËRIT TË TRETË
SHEKULLOR NË IVE

Motër
Mary Mother of Faith, SSVN

Sfidat që lindin nga bindja e të përhapurit në mënyrë efikase Ungjillin në realitetin njerëzor e bëjnë thelbësore e të nevojshme punën komunitare, eskuzive e urdhërit të tretë laik të IVE. Thirrja e saj laike e sjellë në disa mjedise të përkohëshme që në disa raste janë larg nga shenjtërimi «aty ku meshtarët dhe rregulltarët nuk mund të hyjnë sepse forca e tyre nuk është e mjaftueshme për të kënaqur shumë kërkesa ose sepse nuk janë vende të denta për një rregulltarë, duke u munduar në këtë mënyrë për të sjellë shpëtimin në ambjentet më të ulëta dhe të fshehura të realitetit tonë»⁵⁶.



Kështu vjen edhe nevoja për t'iu besuar Atij në zhvillimin e veprave ungjillizuese të kulturës: «Është pjesë kryesore dhe themelore e Familjes së Fjalës së Mishëruar dhe nga e cila familja rregulltare e Fjalës së Mishëruar nuk mund të supozojë, përderisa është edhe përzgjatja e akteve të Instituteve së bashku në sferat përkatëse të jetës laikale»⁵⁷.

Laikët duhet të ushqehen shpirtërisht nga drita që del nga misteri i Mishërimit, në mënyrë që me jetët e tyre dhe apostullatet e tyre konkrete, të mund të ngulisin Ungjillin në të gjitha ato realitete të cilave u përkasin, siç është familja, shoqëria politike, formimi publik, puna etj. Duke mos u bërë fjalë për një identifikim të thjeshtë të jashtëm me jetën e rregulltarëve, personi i urdhërit të tretë i IVE jeton në bashkim me hirin përmes karizmës së cilës i është bashkuar, duke bashkëndarë në këtë mënyrë të mirat shpirtërore të përbashkëta të të gjithë pjesëtarëve të Institutit të Fjalës së Mishëruar. Edhe pse jo të gjithë pjesëmarësit e këtij takimi janë pjesëtarë të Urdhërit të Tretë, kjo konferencë do të jetë e dobishme për ta kuptuar më mirë esencën e saj dhe do i drejtojë edhe në thirrjen e tyre në jetën e përditëshme të krishterë dhe në mënyrën për të dëshmuar Krishtin në botë.

i

Gjuha: Anglisht
Hapet kjo konferencë me një pjesë muzikore me titull: "Hutsulka Ksenia", i korit të motrave ukrainase të noviciatit "E lumja Yosafaty Hordashevkoji".



13:30

Dreka



Kohë e lirë

SHQIP

15:30


Grupe reflektimi

1. APOSTULLATI INTELEKTUAL DHE KULTUROR

Për ta jetuar konkretisht besimin, për ta mbrojtur atë dhe për të lejuar që Ungjilli të depërtojë në inteligjencë dhe të transformojë “mënyrat e të menduarit, kriteret e gjykimit, normat e veprimit”⁵⁸, është e nevojshme të përballemi me apostullatat intelektuale. Për këtë arsye prania e Kishës dhe laikëve duhet të intensifikohet “në pozicionet e privileguara të kulturës, si bota e shkollave dhe universiteteve, mjediset e kërkimit shkencor dhe teknik, vendet e krijimit artistik dhe reflektimi humanist”⁵⁹. Ungjillizimi i kulturës, qëllimi specifik i familjes sonë rregulltare, kërkon aftësinë për të dalluar atë që është autentikisht njerëzore dhe për këtë arsye e shëlbueshme nga ajo që nuk është; për këtë qëllim është i domosdoshëm “një besim i ndriçuar nga një reflektim i vazhdueshëm, i cili ballafaqohet me burimet e mesazhit të Kishës dhe një shqyrtim të vazhdueshëm shpirtëror të marrë nëpërmjet lutjes”⁶⁰.



Prandaj do të mbahen laboratorë formues në lidhje me disiplina të ndryshme (për shembull, filozofia, teologjia, doktrina shoqërore, arti, muzika e shenjtë ...), me qëllimin kryesor të ofrimit të trajnimeve, por gjithashtu për të siguruar që laikët, të vetëdijshëm për rëndësinë e rolit të tyre, të kërkojnë të organizojnë ngjarje trajnimi sikurse në kulturën katolike, botim ose bashkëpunim në revista etj



SHQIP

2. AKTIVITETE KULTURORE

Meqë “kultura”, të cilën ne jemi thirrur për të Ungjillizuar përfshin “bërjen artistiket, artin e njeriut që transformon gjërat materiale në gjëra të bukura”⁶¹, do të ekspozohen gjëra të ndryshme me qëllim ilustrimin të asaj që është një aktivitet i vërtetë njerëzor, i përhapur nga Ungjilli. Meqë qëllimi ynë është ungjillizimi i kulturës si një realitet njerëzor, sigurisht që do të ishte i paplotë nëse nuk do të ndikonte në shprehjen më të lartë njerëzore, dmth. Artin. Ndër iniciativat e IVE Meeting do të ketë, ndër të tjera, një «melodium» (shpjegim dhe analizë e një veprë muzikore), shfaqje të ndryshme nga kori i Familjes sonë Rregulltare, konferenca formuese për rritjen dhe përsosmërinë kulturore dhe ekspozita e disa veprave në sallone të ndryshme.

3. APOSTULLATI PËR JETËN DHE FAMILJEN

Përmes bashkimit të personit të Fjalës me natyrën njerëzore, “Zoti na ka treguar, duke u bërë njeri i vërtetë, vendin më të shquar që natyra njerëzore zë midis krijesave të tjera”⁶², pasi që Fjala është “e së njëjtës substancë me Atin sipas hyjnisë dhe e njëjtës substancë me ne sipas njerëzimit”. Për këtë arsye Urdhri i Tretë dhe miqtë tanë në përgjithësi duhet të angazhohen për promovimin dhe mbrojtjen publike të dinjitetit të personit dhe të gjithë jetës njerëzore, “nga momenti i ngjizjes deri në vdekjen natyrore”⁶³. Është dëshira jonë “që të dalin nga kraharori i Urdhërit të Tretë, laikë që të mbrojnë njeriun, të kujdesen për nevojat e tij dhe të nxisin vlerat e tij. Për shembull: punët e mirëqënies për fëmijët e pastrehë, invalidët ose çdo lloj tjetër nevojtar”⁶⁴. E gjithë kjo kërkon gjithashtu një angazhim për të mbrojtur planin origjinal të familjes dhe martesën sakramentale, për të bërë që të mbretërojnë në të dashuria e Zotit dhe vlerat e krishtera, në mënyrë që bashkëshortët të “formojnë njerëz të fortë, të përgjegjshëm dhe të aftë për të bërë zgjedhje të lira dhe të drejta, duke i përgatitur fëmijët e tyre për një hapje në realitet; duke formuar në to një koncept të caktuar të jetës: konceptimi i krishterë dhe katolik”⁶⁵.



Ndërkohë grupet e reflektimit do të trajtojnë temat e mëposhtme:

FORMIM KULTUROR

i

1. **Muzika e Shenjtë** (At Damiano Grecu, IVE)
2. **Art** (ekspozim dhe shjegim të disa veprave nga ana e At Rodrigo Miranda, IVE)
3. **Art** (ekspozim dhe shjegim i tablove që shpjegojnë historinë e Zojës Luhan të realizuara nga Motër Sacramentado, SSVM)
4. **“Muzeu i Mundimi të Krishtit”**
(At Gabriel Prado, IVE-
Seminari Minor Shën Gjoni i XXIII)
5. **Konferenca “Njeriu dhe Kultura”**
(Diego Ibarra)

FORMIM INTELEKTUAL

1. **Bibla** (At Martín Villagran, IVE)
2. **Teologjia** (At Arturo Ruiz, IVE)
3. **Dotkrina Shoqërore** (At Raul Harriague, IVE)
4. **Bioetika dhe familja** (Stefano Principe)
5. **Historia e Kishës** (At Ricardo Clarey, IVE)
6. **Apostullat me personat e fesë islame**
(At Carlos Pereira, IVE).

SHQIP



Kohë e lirë

17:15

Grupe reflektimi

i

Grupet e ndryshme reflektimi do të përsëriten po në të njëjtat sallone.

19:00

Mesha e Shenjtë në ritin Bizantin

Me celebrimin e Liturgjisë Hyjnore Bizantine ne duam të shpallim se si Institut “jemi anëtarë të një familjeje të vetme rregulltare misionare dhe, mbi të gjitha, jemi fëmijë të Kishës Një, të Shenjtë, Katolike dhe Apostolike, e cila” merr frymë me dy mushkëri: perëndimore dhe lindore»⁶⁶.

Ky celebrim, i zgjedhur për shkak të numrit të madh të pjesëmarrësve nga Ukraina dhe që i përkasin këtij riti, dëshiron të jetë shprehje e qëllimit tonë specifikë, pasi “përzgjatja e mishërimit” në çdo njeri “nënkupton jo vetëm përzgjatjen e saj në burrin dhe në gruan, fëmijën, të rinjtë apo të moshuarit, por edhe në njeriun Perëndimor dhe Lindor, në të gjithë larmishmërinë e riteve dhe në të gjitha Kishat e veçanta përmes të cilave ata janë të bashkuara në të njëjtën Kishë Katolike”⁶⁷.

SHQIP



20:30

Darka

21:30

Ruuzarja e Shenjtë
me qirinj

22:00

Spekatakël

SHQIP



i

Ditën tjetër do të
shkojmë në Bazilikën e
Shën Pjetrit në Vatikan.





2
GUSHT

SHQIP

07:00

Mëngjesi

07:30

Nisja për në Vatikan

Megjithë përpjekjet që do të përfshijë lëvizja e të gjithë pjesëmarrësve të IVE Meeting, ne nuk mund që të mos bëjmë një pelegrinazh në varrin e Apostullit Pjetër, për të shpallur bashkimin tonë të plotë me të dhe me Kishën, pasi “dashuria jonë e tretë e madhe duhet të jetë gjithmonë figura e bardhë e Papës»⁶⁸.



Papa duhet të jetë për ne “prania e mishëruar e së Vërtetës, e Vullnetit dhe e Shenjtërisë së Krishtit”⁶⁹. Gjatë kremtimit të Meshës së Shenjtë, kori do të interpretojë himnin “Romë e Përjetëshme”, e kompozuar nga anëtarët e Familjes Rregulltare, si një shprehje e besnikërisë sonë dhe dashurisë sonë për Kishën Romake, Princi i Apostujve dhe paardhësit e tij.



SHQIP

08:30

Hyrja në Bazilikë

i

Hyrja në bazilikë do të bëhet nëpërmjet “Derës së Bronxit” me një leje të veçantë për pjesëmarrësit e IVE Meeting.



10:00

Mesha e Shenjtë


Udhëheq celebrimin: At Gustavo Nieto, IVE
Gjuha: Italisht

i

NDJESA E PLOTË (INDULGJENCA)

Ju kujtojmë se në këtë ditë është e mundur të merrni ndjesat e plota (indulgjenca plenare) që japen për ata që vijnë për pelegrinazh në Bazilik, nëse keni kushtet e nevojshme për ti marrë (p.sh. rrëfimin sakramental tetë ditë para ose pas dhe një lutje për qëllimet e Atit të Shenjtë).

SHQIP



11:15


Vizitë e udhëhequr

(FAKULTATIVE)

i

Vizita e udhëhequr në bazilikë në gjuhë të ndryshme sipas kërkesave (25'-30').





12:00

Kthimi



Vendi i Takimit: në shesh përkrah obeliskut për një foto si grup. Fillojmë rikthimin në Fraterna Domus.



13:45

Dreka



Eksponohet i Shenjtërueshmi Sakrament dhe qëndron aty për adhurim të përzgjat.



Kohë e lirë

16:00

Konferenca Plenare



**JETA DHE FAMILJA:
PIKA KONKRETE DHE URGJENTE PËR
UNGJILLIZIMIN E KULTURËS**

*Dr. Eduardo e Clara Maggiora,
pjesëtarë të Urdhërut të Tretë të IVE*

Përballë kulturës së vdekjes, shpallja e Mishërimit të Fjalës e kundërshton me kulturën e jetës. Pjesëtari i Urdhërut të tretë i IVE ka si detyrë kryesore sot të shpallë me jetën dhe veprat e tij mbrojtjen e familjes si vlerë të pazëvendësueshme të të gjithë jetës njerëzore, nga ngjizja e deri në vdekje. Këto të vërteta të nënkuptueshme, rezultojnë akoma dhe më shumë bindëse nëse i shikojmë të vendosura në praktikë nga të tjerët. Përderisa është jetësore dhe esenciale për ekzistencën, një e vërtetë e tillë arrihet jo vetëm përmes arsyes por edhe nëpërmjet besimit tek personat e tjerë të cilët na garantojnë më me saktësi dhe autenticitet të vërtetën⁷⁰. Për këtë motiv, nëpërmjet dëshmisë familjare, çifti Maggiora së bashku me të birin Javier, do të trajtojnë argumentin rreth vlerës së familjes dhe jetës, duke u nisur nga eksperiencia e tyre personale.

i

Gjuha: Spanisht

Hap këtë konferencë me një solo me Violinë motër Maria Lubovi SSVM.

Kohë e lirë



17:45

Konferenca Plenare

**PREZANTIME TË MISIONEVE TË FAMILJES
RREGULLTARE TË FJALËS SË MISHËRUAR.**

*At Jesús Segura, IVE
dhe
Motër Maria
Stella del Mare, SSVM*

«Misioni, i marrë nga themeluesi dhe i përcjellë nga Kisha, është të sjellim në mënyrë të plotë rezultatet e Fjalës së Mishëruar që është "prejardhja dhe rrënja e të gjitha të mirave"⁷¹, në mënyrë të vecantë botës së madhe të kulturës, ose më mirë të "shfaqjes thelbësore të njeriut si individ, si shoqëri, si popull, si shtetësi"⁷²»⁷³.

Ungjillizimi i kulturës kërkon që ata që janë të thirrur për këtë thirrje «mos të jenë të limituar në misionin aventurier», por të dëshirojnë të shkojnë në të gjithë botën⁷⁴, duke shpallur Ungjillin për çdo njeri.

Për këtë do të përmbylлим me një prezantim të aktivitetit misionar që Familja jonë Rregulltare prezanton në pesë kontinentet. Përveç faktit e të qënurit formuese, kjo paraqitje kërkon të bashkëndajmë së bashku, si një Familje Rregulltare, të gjithë të mirën që Zoti na sjellë nëpërmjet misionarëve tanë, të cilëve u jemi shumë mirënjohës për veprën e madhe të ungjillizimit që bëjnë, disa prej të cilëve ndodhen në tokë të huaj dhe në situata shumë të vështira.

Gjuha: Italisht

Hapet kjo konferencë me një solo të At Damiano Greco, IVE, me piano forte.

SHQIP

i



Kohë e lirë

19:30

Darika

SHQIP

20:30

*Homazhi Eukaristik
i fëmijëve*

Fëmijët do të këndojnë këngën "Tantum Ergo" të shoqëruar nga Orkestra.

20:45

*Rruzarja e Shenjtë
me qirinj*

21:30

*Përkujtim i të krishterëve
të persekutuar.*

Do të ketë dëshmi të disa rasteve të persekutimit dhe të disa pjesëtarëve të Familjes sonë Rregulltare që kanë qënë dëshmitarë të persekutimit që të krishterët vuajnë në vendet e Lindjes së Mesme, të cilët "japin jetën e tyre në heshtje, sepse martirizimi i tyre nuk bën lajm të rëndësishëm, por sot ka më shumë martirë të krishterë që në shekujt e parë"⁷⁵.

Ata janë për ne një shembull i asaj që do të thotë të jemi “indiferentë përpara parimeve, stalljeve dhe persekutimeve të botës, e varur vetëm nga ndërgjegjja jonë e drejtë e ndriçuar nga besimi, të gatshëm për martirizim për besnikëri ndaj Zotit, e cila përbën kështu një refuzim të plotë dhe total të botës së keqe»⁷⁶. Ky përkujtim do të përfundojë me një lutje në ritin kopt-katolik, pasi këtij riti i përket pjesa më madhe e besimtarëve që vuajnë përndjekje të dhunshme sot.

i

Udhëheq: At Filopatir, IVE
Vendi: Salla Don Françesku

SHQIP



22:15

Spektakël



01:00-
03:30*Adhurim gjatë natës*

(FAKULTATIV)


Adhuresit gjatë natës, qëndrojnë të kujdesshëm kundrejt Zotit të lavdisë, që ka ardhur, që vjen dhe që do të vijë.

«Lum shërbëtorët që, kur kthehet zotëria, i gjen zgjuar! Përnjëmend po ju them: ai vetë do të ngjeshet, ata do t'i ulë në tryezë, do të afrohet dhe vetë do t'i shërbejë. Po erdhi në të dytën ose në të tretën rojë të natës dhe, po i gjeti kështu, lum ata!» (Lc 12,37-38).

i

Vazhdon adhurimi Eukaristik në qetësi me turne gjatë natës...(kjo është fakultative).





3
GUSHT

SHOP

08:45

Bekimi Eukaristik

09:00

Mëngjesi

09:45

Takime me grupet

Takime të grupeve të ndryshme me përgjegjësit e grupeve për të programuar dhe konkretizuar apostullate që do të zhvillohen pas takimit.



i

1. Italia dhe Sqipëria - At Andrés Bonello, IVE
2. Spanja- At José Vicchi, IVE
3. Argjentina - At Emilio Rossi, IVE
4. Ekuador dhe Perù - At Jorge Montagna, IVE
5. USA- At Mariano Vicchi, IVE
6. Filipine - At Bernardo Ibarra, IVE
7. Brasil -At Emanuel Martelli, IVE
8. Ukraina - At Antonio Vatseba, IVE
9. Rusia - At Ezequiel Ayala, IVE
10. Tagjikistan, Kazajstan - At Pedro López, IVE
11. Hong Kong - At Carlos Almonte, IVE
12. Taiwan - At Michael Zhang, IVE
13. Gjermania - At Martín Villagrán, IVE
14. Luksenburg - At Jorge Alvarez, IVE
15. Franca - At Alfredo Alos, IVE
16. Tunizia - At Silvio Moreno, IVE
17. Papua Guinea e Re -At Martín Prado, IVE
18. Lindja e Mesme, Egjpti, Jordania, Iraku dhe Tanzania
At Gabriel Romanelli, IVE
19. Kina - At Mattia Fang, IVE

SHQIP

11:15

Mesha e Shenjtë Përmbyllëse

KUSHTIMI KUNDREJT ZEMRËS SË KRISHTIT TË JEZUSIT PËRMES ZEMRËS SË PAPËRLYER TË ZOJËS MARI

Në vitin 2016 i qe kushtuar Zemrës së Shenjtë të Jezusit e gjitha Familja jonë Rregulltare. Kulti i Zemrës së Shenjtë, “është vepra e fesë më e përsosur, është një dëshirë e plotë dhe absolute për t’iu kushtuar dashurisë së Shëlbuesit Hyjnor, i cili ka si shenjë të gjallë Zemrën e shporuar “është vepra e fesë më e përsosur, është një dëshirë e plotë dhe absolute për t’iu kushtuar dashurisë së Shëlbuesit Hyjnor,



i cili ka si shenjë të gjallë Zembrën e shporuar”⁷⁷. Kjo formë e veçantë e kulti përshtatet shumë mirë me përshpirtmërinë tonë, të themeluar në misterin e Mishërimit të Fjalës, sepse «mbështetet në faktin se Zemra e Tij, që është pjesa më fisnike e natyrës së tij njerëzore, është hypostatikisht e bashkuar me Personin e Fjalës së Zotit dhe, si pasojë, ne duhet t’i japim atij të njëjtin kult adhurimi me të cilin Kisha nderon personin e të njëjtit Bir të Zotit të Mishëruar”⁷⁸.

Për këtë arsye, në ditën e fundit të IVE Meeting, të gjithë pjesëmarrësit do të kryejnë me zërin e tyre Kushtimin kundrejt Zembrës së Shenjtë të Jezusit, nëpërmjet Zembrës së Papërlyer të Marisë, duke u kërkuar këtyre Zembrave të denjohen që të pranojnë, bekojnë dhe mbrojnë Familjen tonë të vogël Rregulltare, komunitetet tona, neve, veprat dhe apostullatet, kështu që gjithçka që jemi dhe bëjmë të jetë një ngushëllim riparues për të gjitha ofendimet që ata marrin.



Në përfundim të kushtimit do të shpërndahet si kujtim një medalje për çdo pjesëmarrës.

13:30

Dreka përmbyllëse

Falenderime dhe çmime

14:30

Fotoja e Fundit

Fotoja e fundit, të gjithë së bashku në Fraterna Domus

SHQIP



REFERENCAT

- 1 Shën Luigji Orione, *Letër drejtuar Bijëve të Provanisë Hyjnore*, 25 Korrik 1936, 151 dhe 152.
- 2 Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor, 5.
- 3 Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor 218; *op. cit.* Kushtetuta 211; cf. *Ad Gentes*, 38.
- 4 Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor, 236.
- 5 Cf. *Lumen Gentium*, 31.
- 6 Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor 7.
- 7 Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor 369.
- 8 Cf. Udbëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor, 236; *op. cit.* *Apostolicam Actuositatem*, 18.
- 9 Sën Luigji Orione, *Lettera ai Figli della Provvidenza*, 25 korrik 1936, 151 e 152.
- i cituar në , Udbëzuesin e Urdhërit të Tretë Shekullor 119
- 10 VEPRAT E APOSTUJVE 4,12
- 11 PIU XI, LETRA ENCIKLIKE *QUAS PRIMAS*
- 12 PIU XI LETRA ENCIKLIKE *QUAS PRIMAS*
- 13 GJN 18,37
- 14 Cfr. SHEN INJACI I LOJOLËS, *Ushtrime Shpirtërore* nr. 97.
- 15 Cfr. 1Kor 15,25.
- 16 «Tha [Jezusi] te gjithëve: «Kush do të me ndjeke mua, të mohoje veten, të marrë kryqin e tij çdo ditë e të me ndjeke» (Lk 9,23)
- 17 Cfr. SHEN INJACI I LOJOLËS, *Ushtrime shpirtërore* nr. 95z
- 18 Cfr. *Kushtetuta*, 5.
- 19 Cfr. C. FABRO, *Përshkrim i ateizmit modern*, EDIVI, Segni 2011, prezantim.
- 20 Cfr. *Kushtetuta* 176
- 21 *Kushtetuta* 172.

- 22 *Kushtetuta* 11.
- 23 *Udhëzues i Urdhërit të tretë*. 5.
- 24 *Lumen Gentium*, n.31.
- 25 SHËN LUIGJI ORIONE, *Letër e Don Oriones*, 02/08/1935, Edit. Pio XII, Mar del Plata, 1952, p. 89. Cituar nga Udhëzuesi i Përshpirtërisë i *IVE*, nr. 126.
- 26 SHËN GJON PALI I II, *Apostolicam Actuositatem*, n. 7.
- 27 Udhëzuesi i Jetës Rregulltare, 2. Cfr. edhe në letren e at. G. Nieto të 1/09/2017 (edizione italiana di G. Nieto, *Custodite il Carisma*, ED.IVE, Montefiascone 2019, p. 197).
- 28 Citim e Kapitulli të V gjeneral (2007), n. 8. Cituar nga At G. Nieto, *Custodite il Carisma*, ED.IVE, Montefiascone 2019, fq.203.
- 29 Kapitulli i V gjeneral (2007), n. 8. Cituar nga at G. Nieto, *Custodite il Carisma*, ED.IVE, Montefiascone 2019, p. 203.
- 30 Ibidem. (i njëjti citim)
- 31 Udhëzuesi i përshpirtërisë
- 32 Kushtetuta,92
- 33 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 308.
- 34 SHËN PJETËR GJULIANO EYMARD, *Vepra Eukaristike*, Ed. Eukaristia, 1963, fq. 763-764. Cituar nga *Kushtetuta*, n.142.
- 35 *Kushtetuta*, 11
- 36 Mt 19, 14
- 37 Cfr. SHËN AGUSTINI, *Ekspozim i Letrës së Partëve, homilia nr.6*
- 38 Shën GJON PALI I II, *Mesazh për motivin e kapitullit gjenerat të fjetërve predikatorë*, 28/6/2001
- 39 GJON PALI I II, *Mesazh për motivin e kapitullit gjenerat të fjetërve predikatorë*, 28/6/2001.
- 40 Ibidem. (i njëjti citim)
- 41 G.K. CHESTERTON, *Heretikët, Kapitolo 6*.
- 42 GJON PALI I II, *Mesazh për motivin e kapitullit gjenerat të fjetërve predikatorë*, 28/6/2001.
- 43 Ibidem.
- 44 *Kushtetuta* 7.
- 45 *Kushtetuta*, 171.
- 46 PIU XI, MENS NOSTRE, 24.
- 47 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 116.
- 48 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 353.
- 49 *Udhëzuesi i Oratorëve*, 51.
- 50 *Udhëzuesi i famullive*, 112.

- 51 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 313.
- 52 Cfr. Shën Toma i Akuinit, *Summa Theologiae*, I-II, q. 95, a. 4.
- 53 *Dignitatis humanae*, 3
- 54 *Për shembull, themelimi i festës së Krishtit Mbret lind si nevojë për devocion ndaj Zemrës së Shenjtë: «E kush nuk sheh që gjatë fundit të shekullit të kaluar përgatitej kaq bukur rruga e institutit të kësaj feste? Të gjithë e dinë që autoriteti i Krishtit është njohur nga praktikat e mëshirës, e devotsshmërisë e homazhit kundrejt Zemrës së Shenjtë të Jezusit. Të udhëbequra nga shumë familje dhe nga Shtete e Mbretëri, që kanë kryer të njëjtin akt»* (PIO XI, *Quas Primas*, 26).
- 55 PAPA LEONI I XIII, *Rerum Novarum*, n. 13.
- 56 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 91.
- 57 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 5.
- 58 *Kushtetuta*, 206.
- 59 SHËN GJON PALI I II, *Christifideles laici*, 44.
- 60 SHËN GJON PALI I II, *Fjalim ipeshkëvinjëve të Zimbabve* (02-07-2988), 7.
- 61 *Udhëzuesi i Ungjillizimit të Kulturës*, 33.
- 62 Shën Agustini, *De Vera Religione*, 30.
- 63 SHËN GJON PALI I II, *Fjalim në asamblenë e Përgjithëshme të Mjekëve botëror*, 2.
- 64 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 469.
- 65 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 353.
- 66 *Udhëzuesi i Ritit Lindor*, 5.
- 67 *Udhëzuesi i Ritit Lindor*, 15.
- 68 *Udhëzuesi i Përsëpirtërisë*, 309.
- 69 *Kushtetuta*, 12.
- 70 SHËN GJON PALI I II, *Fides et Ratio*, 33.
- 71 SHËN GJON KRIZOSTOMO, *In Matt. Hom.*, II, 3.
- 72 GJON PALI I II, *fjalim njerëzve të kulturës me rastin e Jubileut të Mëshërimit*.(15/12/1983), 3; OR (25/12/1983), p. 6.
- 73 *Kushtetuta* IVE, n. 32.
- 74 Mk 16, 15.
- 75 PAPA FRANÇESKU (25-05-2019)
- 76 *Udhëzuesi i Urdhërit të Tretë Shekullor*, 50.
- 77 PIU XII *Haurietis Aquas*, 2.
- 78 PIU XII *Haurietis Aquas*, 6.



*E Fjala u bë njeri,
dhe banoi ndër ne*